



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
**Kryesia**

Prot 491/11

Tiranë, <sup>20</sup>\_\_6.2023

**Vendim**

Nr. <sup>31</sup>\_\_ datë <sup>20.06</sup>\_\_2023

**Për ringritjen e njësisë së kërkim-studimit  
në fushën e inteligjencës artificiale**

**Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 59/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë;**

**Në pajtim me nenin 45 të Statutit të ASHSH;**

**Me propozim të nëngrupit të informatikës në përbërje të komisionit të përhershëm të matematikës dhe informatikës pranë ASHSH dhe Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike (bashkëngjitur);**

**Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 20.06.2023:**

**Vendosi:**

**1. Njësia e kërkim-studimit për inteligjencës artificiale, e themeluar me vendimin nr. 17 datë 05.03.2021 të Kryesisë së ASHSH, të vazhdojë të veprojë me të njëjtin status si në vendimin sipërcituar edhe për dy vjet të tjera, duke filluar nga data 20.6.2023.**

**2. Njësia të ketë në përbërje këta kërkues: akad. Arjan Durrësi, (drejtues shkencor), akad. Neki Frashëri (bashkëdrejtues), prof. dr. Betim Çiço (anëtar), akad. asoc. Kozeta Sevrani (anëtar), prof. asoc. dr. Elinda Kajo (anëtare), prof. asoc. dr. Alda Kika (anëtare).**

3. Objekti i punës së njësisë për dy vitet në vijim (20.06.2023 – 20.06.2025), përveç dokumentit të paraqitur në kohën e themelimit (bashkëngjitur), specifikohet në detyrat e përcaktuara në platformën dhe programin analitik të punës (bashkëngjitur).

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryetari i SSHNT, drejtuesit e njësisë dhe kancelari.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Akad. Skënder GJINUSHI**

**KRYETAR**

